REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr.288/13 Prot

Tiranë, më 03/03/2021

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE

DREJTORISË RAJONALE TË OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 11, datë 3.3.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", Urdhërit të Kryeministrit datë 24.12.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive" i ndryshuar me Urdhërin nr.107, datë 13.08.2020 dhe shkresës nr.22/4 prot, datë 16.02.2021 "Njoftim për shpallje vend të lirë pune" të Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik Shkodër, protokolluar pranë AKPA-s me nr.288/2 prot, datë 22.02.2021, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në portalin e AKPA-së, brenda datës 05.03.2021, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

- Mësimdhënës me kohë të pjesshme i formimit teorik–praktik për kursin "Start - Smart".

1. Kritere të përgjithshme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2.Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të të formimit teorik-praktik në Drejtorinë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik Shkodër

a) të ketë miminalisht diplomë nga një shkollë e mesme profesionale/ pas të mesëm, kualifikim profesional mbi një vit në fushën/profesionin që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të formimit profesional;
b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën është arsimuar;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

3. Dokumentet e aplikimit
a) letër motivimi për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit *Europass* në shtojcën 1, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

c) të dhënat e aplikuesit, të plotësuara sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2, të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

d) fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të librezës së punës;

e) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
f) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

g) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

h) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

i)vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

j) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik Shkodër, brenda datës 25.03.2021.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ